



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 3044
NR. 1951 S.P./3044 AKTI
NR. 2509 VENDIMI

Dt. rregj. 21.07.2021 SP/ 21.09.2021 regj.them.
28.09.2021

NR. VENDIMI 2509

Dt.

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

Gjyqtar: SOKOL PASHO

asistuar nga sekretare gjyqesore Etleva Avdia, me pjesëmarrjen e prokurorit Julian Xhengo sot me date 28.09.2021, mori në shqyrtim çështjen penale që i përket:

I PANDEHUR:

Elson Rumi, i biri i Sulejman dhe Mimoza, dtl. 25.08.1996, lindur dhe banues në Tiranë, Blloku Vasil Shanto, rruga “23”, beqar, me arsim të mesëm, i padënuar më parë, i perfaqësuar me autorizim nga av. Dritan Trifka, Anetar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me nr. 3716 liçense.

AKUZUAR:

Për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, te parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.

2. Pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 1384, të vitit 2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal për:

Personin nën hetim:

Kris Gjore, i identifikuar me leternjoftimin me nr. J61209039A, i biri i Maksim dhe Merita, i dtl. 09.12.1996, lindur dhe banues ne Tirane, Rr. “Myslym Shyri”, pallati 60, shk.2, ap.27, me shtetsi shqiptare, beqar, me arsim te mesem, i padenuar me pareë, i mbrojtur ne gjykim nga av. Eno Seferi, Anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me nr. License 9356.

Gjykata, pasi pranoi kërkesën e të pandeurit për gjykim të shkurtuar dhe në përfundim

dëgjo prokurorin që kërkoi:

Prokurori Julian Xhengo :

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Elson Rumi, për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike“ të parashikuar nga neni 283/prg.1 i Kodit Penal dhe në mbështetje të këtij neni, dënimin e tij me 6 (gjashtë) vjet burgim.
- Sugjerojmë Gjykatën që në caktimin e dënimit të aplikohen përcaktimet e nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale duke e dënuar të pandehurin me 4 (katër) vjet burgim.
- Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal të pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim dhe të vihet I pandehuri në provë për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh.
- Në bazë të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, lënda narkotike e sekuestruar, të asgjësohet.
- Shpenzimet procedurale të kryera gjatë hetimeve paraprake, në shumën 3.000 (tremijë) lekë, t’i ngarkohen të pandehurit.
- Pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 1384, të vitit 2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, për personin nën hetim Kris Gjore.

Avokati i te pandehurit Elson Rumi:

- Deklarimin fajtor të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal. Në lidhje me masën dhe dënimit i kërkojmë gjykates aplikimin e nenit 59 te K.penal duke pezulluar gjykata dënimin dhe venien në provë të të pandehurit për pjesën e pavuajtur te dënimit.

Avokati i personit ne hetim Kris Gjore:

- Pranimin e kërkeses se prokurorit për pushimin e çështjes penale për personin nën hetim Kris Gjore.

V E R E N

Se Prokuroria i është drejtuar Gjykates me kërkesën nr. 1951 Akti, datë 21.07.2021 regjistrimi me objekt: Dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal me nr. 1384 të vitit 2021, në ngarkim të të pandehurit Elson Rumi, i akuzuar për veprën penale “Prodhimi dhe shitje e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, si dhe pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 1384, të vitit 2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, për personin nën hetim Kris Gjore, duke i bashkëlidhur kërkeses edhe aktet dhe provat që përmban fashikulli përkatës.

I pandehuri Elson Rumi gjatë hetimeve paraprake nuk ka paraqitur kontestime, ndërsa në seancën paraprake, ai kërkoj gjykim të shkurtuar, duke pranuar që gjykimi të zhvillohet në gjëndjen që janë aktet në fashikullin e Prokurorisë të sjellë për gjykim, ndaj dhe Gjykata bazuar në nenet 405 dhe 406 të K.Pr.Penale, u shpreh dakord që të procedohet me gjykim të

shkurtuar, duke çmuar për zgjidhjen e çështjes penale në gjëndjen që janë paraqitur aktet nga Organi i Prokurorisë, pasi nga palët nuk pati pretendime pavlefshmërie, papërdoshmërie, për aktet si dhe të tjera kërkesa paraprake të kësaj natyre.

Gjykata, në respektim të dispozitave ligjore (nenit 405 të K.Pr.Penale), duke vlerësuar se aktet janë të plota dhe se çështja mund të zgjidhet në gjëndjen në të cilat ndodhen këto akte, vendosi zhvillimin e gjykimit të shkurtuar, duke pranuar kërkesën e bërë nga i pandehuri.

Në mbështetje të dispozitave të posaçme procedurale si dhe të Vendimit Unifikues Nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara, ky lloj gjykimi i posaçëm eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Në këto kushte fashikulli (dosja) e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore duke marrë vlerën e provës pas pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar. Në këtë fashikull bazohen konkluzionet përfundimtare të palëve si dhe gjykata në dhënien e vendimit.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 23.02.2021, ka regjistruar procedimin penal Nr.1384 për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Ky procedim është regjistruar mbi bazën e materialeve të referuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, me shkresën Nr.4114, datë 23.02.2021.

Nga shqyrtimi i akteve rezultoi e provuar se, nga ana e seksionit të Narkotikeve në Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, është marrë informacion në rrugë operative se në zonen e rrugës “Vasil Shanto” shtetasi Elson Rumi merret me shitje të lëndëve narkotike të llojit kokainë dhe kanabis sativa dhe lëviz me automjetin me targa AA038FF.

Rreth orës 20:00 nga ana policisë është konstatuar automjeti tip Volkswagen me targë AA038FF në kryqëzimin e 21 Dhjetorit, ku në timon ka qenë shtetasi Elson Rumi dhe më pas ka ndaluar në rrugën “Myslym Shyri” dhe ka takuar një person tjetër ku dhe kanë qëndruar për disa minuta. Më pas personi që takoi, që më vonë është identifikuar si shtetasi Kris Gjore, ka hipur në vendin e drejtuesit në automjetin me targa AA038FF dhe shtetasi Elson Rumi si pasagjer në vendin e parë dhe kanë filluar levizjen drejt Blv. "Zhan D'ark", kryqezimi i Vasil Shantos deri në rrugën nr.23 (mbrapa shkolles Vasil Shanto).

Pasi është ndaluar mjeti, ka zbritur shtetasi Elson Rumi dhe është ngjitur në katin e dytë të nje pallati ngjitur vendit ku u parkua automjeti, ndërsa shtetasi Kris Gjore ka ndenjor në makinë duke pritur. Pas disa minutash ka dalë nga banesa shtetasi Elson Rumi dhe, kur ka zbritur në katin e parë, në shkalle, është ndaluar nga ana policisë, ku në pjesën e të brendshmeve i është gjetur një qese si ato farmaceutike me lëndë të dyshuar cannabis sativa dhe një qese si ato farmaceutike me dy qese të mbyllura me djegie ne forme doze me lëndë të dyshuar narkotike të llojit kokaine.

Më pas është ushtruar kontroll në banesën e shtetasit Elson Rumi, ku në dhomën e tij të gjumit, në dollapin e rrobave, në një sirtar, janë gjetur dy kavanoza qelqi brenda të cilëve u konstatua material bimor me karakteristika të lëndës narkotike cannabis sativa, ne një qese plasmasi ngjyrë të bardhe u konstatua material bimor me karakteristika si ato te lëndës narkotike cannabis sativa, në një vazo qelqi pak më të vogël u konstatuan disa qese të mbeshjtjella brenda të cilave u konstatua pluhur i bardhë me karakteristika të lëndës narkotike kokaine, një peshore elektronike e dyshuar me mbetje të lëndës narkotike kokaine, si dhe rreth 200 copë qese si ato farmaceutike me vetëmbyllje. U fiksuan provat materiale të gjetura

dhe sekuetruara në banesë, si dhe shtetasit e mësipërm janë shoqeruar pranë ambienteve të DVP Tirane për veprime të metejshme. Shtetasi Kris Gjore ka deklaruar se ai nuk ka patur dijeni për faktin që shtetasi Elson Rumi kiste lëndë narkotike.

Nga akti i ekspertimit kimik Nr.4006, datë 30.04.2021, ka rezultuar se një pjesë e lëndës së sekuestruar shtetasit Elson Rumi tregon për praninë e kokainës dhe është me peshë 0,616 gramë ndërsa një pjesë tjetër është cannabis produkt herbal i bimës cannabis sativa L dhe është me peshë 0,674 gramë.

Nga akti i ekspertimit kimik Nr.4581, datë 14.05.2021, ka rezultuar se një pjesë e lëndës së sekuestruar shtetasit Elson Rumi tregon për praninë e kokainës dhe është me peshë 7,476 gramë ndërsa një pjesë tjetër është cannabis produkt herbal i bimës cannabis sativa L dhe është me peshë 60,189 gramë.

Këto rrethan u provuan me :

- Raport shërbimi, datë 22.02.2021.
- Procesverbal i kapjes në flagrancë, datë 22.02.2021.
- Procesverbal i kontrollit të banesës, datë 22.02.2021.
- Dy procesverbale të sekuestrimit të provave materiale, datë 22.02.2021.
- Procesverbal i arrestimit në flagrancë, datë 23.02.2021.
- Procesverbalet e deklarimeve të dhëna nga shtetasit Elson Rumi dhe Kris Gjore, datë 23.02.2021.
- Procesverbal i këqyrjes dhe marrjes së provave materiale, datë 22.02.2021.
- Akt ekspertimi kimik Nr.4006, datë 30.04.2021, dhe akt ekspertimi kimik Nr.4581, datë 14.05.2021, etj.
- Materialet në ngarkim të të pandehurve që janë përpiluar gjatë hetimeve paraprahe.
- Akte te tjera proceduriale te gjendura ne fashikull.

Mbi bazën e këtyre fakteve nga akuza u kërkua deklarimi fajtor i të pandehurit Elson Rumi, për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve”, të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe dënimi i tij, në masën e përcaktuar në pjesën hyrëse të këtij vendimi, duke parashtruar se me veprimet e tij të kryera me dashje, i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 të K.Penal, si dhe pushimi i çështjes lidhur me procedimin penal nr. 1384, të vitit 2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, për personin nën hetim Kris Gjore.

Arsyetimi i Gjykates, argumentat juridike, interpretimi dispozitave penale, analiza e provave.

Në këto rrethana, e ndodhur përpara këtyre parashtrimeve, përcaktimit të faktit dhe provave në gjykim, Gjykata çmon se veprimet e të pandehurit Elson Rumi, plotësojnë të gjithë elementët që kërkon legjislacioni penal shqiptar, për t'i cilësuar këto veprime si elementë të figurës së veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve”, në formën e mbatjes, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal i Republikës së Shqipërisë.

Në permbajtjen e nenit 283 të K.Penal, të miratuar me Ligjin Nr.7895, datë 27/01/1995, sanksionohet se:

“Shitja, ofrimi per shitje, dhenia ose marrja ne cdo forme, shperndarja, tregtimi, transportimi, dergimi, dorezimi si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farerave te bimeve narkotike, ne kundershtim me ligjin, ose ne kapercim te permbajtjes se tyre, denohet me burgim nga pese gjer ne dhjete vjet.

Po kjo veper, kur kryhet ne bashkëpunim ose me shume se nje here, denohet me burgim nga shtate gjer ne pesembedhjete vjet.

Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, denohen me burgim nga dhjete gjer ne njezet vjet.”

Sipas kësaj dispozite, veprimet që çënojnë marrëdhëniet e sipërpërmendura passjellin përgjegjësi penale.

Këto veprime, për t’u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet që:

-të kenë prekur marrëdhëniet juridike (dispozitat përkatëse ligjore) që rregullojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen transportimin, mbajtjen apo përdorimin vetjak të lëndëve narkotike;

-nga ana objektive këto veprime duhet të jenë aktive, me anë të të cilave personi të kryejë shitje, blerje, mbajtje, transportim, tregëtim, shpërndarje, dorëzim të lëndëve narkotike, në mënyrë të kundraligjshme e shoqërisht të rrezikshme;

-subjekti që kryen këto veprime duhet të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret të ketë mbushur 14 vjeç;

-Veprimet e autorit të veprës penale duhet të kryhet me dashje direkte.

Objekti i veprës penale, janë marrëdhëniet juridike të vendosura me Ligjin Nr.7975, datë 26/07/1995 “Për barnat narkotike dhe psikotrope”, për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, veçanërisht jetën dhe shëndetin e personit, rregjimin juridik për shitjen, dhënie, marrjen dhe mbajtjen e substancave narkotike dhe psikotrope, të mbrojtura me legjislacionin tonë penal nga veprimet apo mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive kjo vepër penale është konsumuar nga i pandehuri Elson Rumi, me veprimet e kundershtimit të manifestuar në formën e mbajtjes së lëndës narkotike, që sipas aktit të ekspertimit kimik nr.4006, datë 30.04.2021, ka rezultuar se një pjesë e lëndës së sekuestruar shtetasit Elson Rumi tregon për praninë e kokainës dhe është me peshë 0,616 gramë ndërsa një pjesë tjetër është cannabis produkt herbal i bimës cannabis sativa L dhe është me peshë 0,674 gramë dhe nga akti i ekspertimit kimik nr.4581, datë 14.05.2021, ka rezultuar se një pjesë e lëndës së sekuestruar shtetasit Elson Rumi tregon për praninë e kokainës dhe është me peshë 7,476 gramë ndërsa një pjesë tjetër është cannabis produkt herbal i bimës cannabis sativa L dhe është me peshë 60,189 gramë.

Nga ana subjektive, vepra penale është kryer nga i pandehuri me faj në formën e dashjes direkte, pasi i pandehuri ka parashikuar kundërligjshmërinë e veprimeve të tij dhe pasojat e veprës.

Subjekt i kryerjes së kësaj vepre penale është i pandehuri Elson Rumi, që nga hetimi gjyqësor rezultoi të jetë i përgjegjshëm para ligjit penal dhe ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.

Duke pasur parasysh sa më sipër Gjykata çmon se, i pandehuri Elson Rumi, ka konsumuar në tërësi me sjelljen e tij të kundraligjshme anën objektive të veprës penale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike të parashikuar nga neni 283 paragrafi i parë i Kodit Penal.

Referuar, analizës juridike si më sipër, Gjykata vlerëson se për shkak të bindjes së saj të krijuar mbi provat e administruara në gjykim mbi fajësinë e plotë të të pandehurit Elson Rumi, në veprimtarinë e kundërligjshme të lidhur me mbajtjen e lëndës narkotike të sekuestruar, të analizuar më sipër, në rastin konkret vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri, është kualifikuar drejt nga organi i akuzës sipas cilësimit të duhur juridik, të konkluduar nga konsumimi plotësisht prej të pandehurit i të gjithë elementeve të figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Veprimet e kryera nga i pandehuri lidhur me mbajtjen e lëndës narkotike, janë në kundërshtim me rregullimin e parashikuar në dispozitat e Ligjit Nr.7975, datë 26/07/1995 “Për barnat narkotike dhe psikotrope”, ligj i cili e klasifikon “Cannabis Sattiva” dhe “Kokainë”, si lëndë narkotike.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin Klodian Rrapo, Gjykata merr në konsideratë rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale e reflektuar në rëndësinë e marrëdhënieve juridike që prek, menyrën dhe formën e kryerjes së veprës penale.

Gjykata bazuar në nenet 47, 48, 49 të K.Penal, merr parasysh, shkallën dhe formën e fajit të të pandehurit në kryerjen e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të të pandehurit, i cili nuk ka precedent penal për kryerjen e ndonjë veprë tjetër penale (siç rezulton nga vërtetimi i gjendjes gjyqesore), sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, si dhe gjendjen shëndetësore të të pandehurit (nga akti i ekspertimit mjeko ligjor nr. 1416, datë 22.06.2021 rezulton se shtetasi Elson Rumi vuan nga sëmundje Astmës Bronkiale me obstrukcion bronkial formë e rendë, gjendje pastabilizuar, me kriza të shpeshta dispneje, të forta të paparashikuara kërcënuese për jetën, si dhe nga Rhiniti alergjik).

Gjithsesi, në një vlerësim të hollësishëm të përmbajtjes, konstatimeve si dhe të të gjitha rrethanave të kryerjes së veprës penale nga i pandehuri, Gjykata konkludoi se lloji i dënimit me burgim për të pandehurin Elson Rumi, i kërkuar nga organi i akuzës është në raport të drejtë me vlerësimin e rrethanave të kryerjes së veprës penale dhe do të realizojë njëkohësisht jo vetëm qëllimin e ndëshkimit të të pandehurit për veprën penale të kryer, por edhe atë të rehabilitimit, edukimit dhe riintegritimit të të pandehurit në të ardhme në shoqëri.

Gjykata, duke marrë në vlerësim të veçantë gjendjen e rënduar shëndetësore të të pandehurit, rrethanat e kryerjes së veprës, si dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale nga ku rezulton se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, në respektim të kërkesave të nenit 59 të K.Penal (i ndryshuar), vlerëson njëkohësisht të aplikojë ndaj të pandehurit Elson Rumi, dënimin alternativ të “Pezullimit të ekzekutimit të vendimit penal”, të kërkuar edhe nga prokurori dhe vënien në kohë prove të tij për një afat prej 4 (katër) vjetësh.

“Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë.” (I dryshuar me **Ligjin** Nr. 36/2017, Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i Ndryshuar.

Neni 59 i K.Penal, parashikon se: “Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave,

veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhëroj, që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.

Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shumë detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi.

Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata.”.

Afati i provës, me përjashtim të rregullit të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, është 24 muaj deri në 5 vjet. Afati i provës fillon, nga e nesërmja shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim. Afati i provës mund të shkurtohet ose zgjatet në varësi të mënyrës së ekzekutimit të provës dhe kushteve personale të të dënuarit, por pa cënuar afatin minimal dhe maksimal të parashikuar në këtë paragraf.”.

Gjykata e urdhëron të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës dhe të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi. Kur i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës ose kur nuk i përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi, të urdhëruara nga gjykata, kjo e fundit vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes gjatë periudhës së provës ose revokimin e vendimit për lirin para kohe me kusht.”.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë e autorit të veprës penale përfshihet në kategorinë e alternativave të dënimit me burgim dhe synon të zgjerojë mundësitë e edukimit dhe rehabilitimit në shoqëri të personit që ka kryer veprën penale në forma të ndryshme nga ajo e kufizimit të lirisë së tij personale. Në rastin konkret, Gjykata çmon se riedukimi i të pandehurit mund të realizohet pa qënë e nevojshme që ai të izolohet nga shoqëria.

Gjykata në bazë të nenit 60/a dhe nenit 60/9 të K.Penal, urdhëron të pandehurin të mos shoqërohet me persona të dënuar.

Lidhur me kërkesën e prokurorit për pushimin e hetimeve për veprën penale “Moskllëzimi i krimi” e parashikuar nga neni 300 i K.Penal në ngarkim të personit në hetim Kris Gjore, Gjykata çmon se kërkesa e organit të prokurorisë është e drejtë pasi në zbatim të parashikimeve të nenit 329/a të K.pr.penale, procedimi i rregjistruar për një krim pushohet me kërkesë të prokurorisë kur konstatohen rastet e parashikuara nga neni 328 pg.1 i Kodit Penal.

Nenin 329/a pg.1 i K.Pr.Penale, parashikon se:

“1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes.”

Neni 328 pg.1 i K.Pr.Penale, parashikon se :

“1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur:

- a) del qartë se fakti nuk ekziston;
- b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;
- c) viktima nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij;
- ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet;
- d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë;
- dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai;
- e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale;
- e) i pandehuri vdes;
- f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj.”

Gjykata vlerëson se kërkesa është e drejtë për sa kohë që nuk u provua dijenia e personit nën hetim lidhur me lëndë narkotike që i është sekuestruar të pandehurit. Sikurse rezulton nga aktete e administruara, personit nën hetim Kris Gjore është gjendur në makinë në kohën që forcat e policisë kanë ndaluar dhe kontrolluar të pandehurin Elson Rumi, duke zbritur nga banesa e tij, ku dhe i është gjetur e sekuestruar lëndë narkotike. Për më tepër, nga procesverbali i pyetjes së personit nën hetim Kris Gjore, rezulton se ky i fundit që në fillim ka deklaruar se vetëm e ka shoqëruar me makinë të pandehurin Rumi, pasi ky i fundit i ka kërkuar meqënëse i kishin pezulluar lejen e drejtimit të mjetit. Kësisoj nuk provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dijenia e personit nën hetim Kris Gjore, për lëndën narkotike që dispononte i pandehuri Elson Rumi, e aq më tepër fajësia e tij.

Në këto kushte, Gjykata çmon se duhet të vendosë pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 1384 të vitit 2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për personin nën hetim Kris Gjore.

Për sa i përket shpenzimeve gjyqësore ato duhet t’i ngarkohen të pandehurit, pasi atij i referohet dënimi në zbatim të nenit 393 të K.Pr.Penale.

Për sa u analizua u provua me pretendimet e palëve në seancë dhe provat shkresore të ndodhura në dosje pjesë përbërëse e fashikullit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE

Në vështrim të neneve 379, 384, 390, 405, 406 të K.Pr.Penale dhe neneve 283/1 e 59 të Kodit Penal, Gjykata:

V E N D O S I:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Elson Rumi, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/1i Kodit Penal dhe dënimin e tij, me 6 (gjashtë) vjet burgim.
- Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar

përfundimisht të pandehurin Elson Rumi, me 4 (katër) vjet burgim.

- Në bazë të nenit 59 të K.Penal dhe 61 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për një kohë prove prej 4 (katër) vjetësh, me kusht që i pandehuri gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Zyrën Vendore, të Shërbimit të Provës, Tiranë.
- Afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.
- Në bazë të nenit 60/9 të K.Penal, urdhërohet i pandehuri që të mos shoqërohet me persona të dënuar, gjatë kohës së provës.
- Në bazë të nenit 260/1 të K.Pr.Penale shuarjen e masës së sigurimit “Arrest në burg” për të pandehurin Elson Rumi, caktuar me vendimin me Nr. 317 Akti, datë 25.02.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Urdhërohet lirimi i të pandehurit Elson Rumi, nga I.E.V.Penale “Jordan Misja”, nr. 313, Tiranë në qoftë se nuk ka masë tjetër siguri ose vendim tjetër dënimi të formës së prerë.
- Në bazë të nenit 190/1/b të K.Pr.Penale, lënda narkotike e sekuestruar me proces-verbalin e datës 22.02.2020 urdhërohet që të asgjësohet.
- Pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 1384 të vitit 2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, për personin nën hetim Kris Gjore.
- Shpenzimet procedurale të fazës së hetimit paraprak, si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, brënda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të tij.
- U shpall sot në Tiranë, më datë 28.09.2021.

Shpenzimet të Prokurorisë

3000 lekë

Shpenzimet gjyqësore

Njoftime 150 lekë